

VENDIM
Nr. 534, datë 25.9.2025

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE 3038, FSHATI
POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMEÑAS, BASHKIA FIER, QARKU
FIER, NGA SHOQËRIA “IDI 2005” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: shoqëria “IDI 2005” sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS: K61507510N;
- c) Tipi i centralit: fotovoltaik;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 8.8 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës dhe plan-vendosja sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionin e projektit;
- g) Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;
 - iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shumat duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;
 - v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

KOORDINATAT NË KRRGJSH PËR “IDI 2005” 8.8 MW					
Nr.	E	N	Nr.	E	N
P1	451416.545	4510649.759	P5	451494.929	4510457.817
P2	451514.709	4510734.979	P6	451846.969	4510742.033
P3	451403.909	4510870.472	P7	451729.451	4510889.864
P4	451302.325	4510784.825	P8	451381.021	4510596.427

